

LIGJ
Nr. 44/2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 52/2024,
“PËR ETIKETIMIN E PRODUKTEVE ME NDIKIM NË ENERGJI”¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 81, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozim të një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 52/2024, “Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji”, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 1 pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) përcaktimin e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta të projektimit ekologjik për produktet me ndikim në energji, në përputhje me parimet e përcaktuara në këtë ligj, me qëllim uljen e ndikimit mjedisor gjatë ciklit të jetës së produktit, rritjen e eficiencës së energjisë dhe garantimin e sigurisë së furnizimit me energji.”.

Neni 2

Në nenin 2 bëhet shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Ky ligj zbatohet gjithashtu për përcaktimin e kërkesave të projektimit ekologjik të produkteve me ndikim në energji, përfshirë qëndrueshmërinë, eficiencën e burimeve, zvogëlimin e materialeve të rrezikshme, riparueshmërinë, riciklueshmërinë dhe zgjatjen e jetëgjatësisë së produktit.”

2. Në pikën 3, shkronja “a”, ndryshohet, si më poshtë:

“a) produktet e përdorura, përveçse kur importohen, si dhe përjashtimet kur kërkesat e projektimit ekologjik përcaktojnë detyrime të posaçme për komponentët dhe pjesët e zëvendësueshme.”.

Neni 3

1. Në nenin 3 pas pikës 33 shtohen pikat 34 deri 40 me këtë përmbajtje:

“34. “Projektim ekologjik” nënkupton integrimin e aspekteve mjedisore në projektimin e produktit me qëllim përmirësimin e performancës mjedisore të produktit gjatë gjithë ciklit të tij jetësor.

35. “Cikli i jetës së produktit” është periudha që përfshin prodhimin, shpërndarjen, përdorimin, mirëmbajtjen dhe fundjetën e produktit.

36. “Aspekt mjedisor” nënkupton një element ose funksion të një produkti që mund të ndërveprojë me mjedisin gjatë ciklit të tij të jetës.

¹ Ky ligj është përafuar pjesërisht me Direktivën (BE) 2009/125 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 21 tetor 2009, “Për përcaktimin e kërkesave për projektimin ekologjik të produkteve me ndikim në energji”. Numri CELEX 32009L0125, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 285, datë 31.10.2009, f. 10–35, si dhe pjesërisht me Rregulloren (BE) 2024/1781 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 qershor 2024, “Për përcaktimin e kërkesave për projektimin ekologjik të produkteve të qëndrueshme”. Numri CELEX 32024R1781, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 1781, datë 28.6.2024, f. 1–89.

37. “Kërkesë e projektimit ekologjik” është një kërkesë e performancës ose një kërkesë informacioni që synon ta bëjë një produkt më të qëndrueshëm për mjedisin, duke përfshirë proceset që ndodhin përgjatë zinxhirit të vlerës së produktit.

38. “Klasë e performancës” është një sërë nivelesh të performancës në lidhje me një ose më shumë parametra produkti, e cila përcaktohet bazuar në një metodologji të përbashkët për produktin ose grupin e produktit, të renditur në mënyrë të tillë që të lejojë diferencimin e produktit.

39. “Marka CE” është një markë me të cilën prodhuesi tregon se produkti përkatës është në përputhje me kërkesat e zbatueshme të përcaktuara në legjislacionin e harmonizimit të Bashkimit Evropian që parashikon vendosjen e saj.

40. “Zinxhiri i vlerës” nënkupton tërësinë e aktiviteteve dhe proceseve që përbëjnë ciklin jetësor të një produkti, duke përfshirë gjithashtu fazat e ripërdorimit, riparimit, riciklimit ose riprodhimit të mundshëm të tij.”.

Neni 4

Në nenin 6 pas pikës 5 shtohen pika 6 dhe 7 me këtë përmbajtje:

“6. Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë dhe ministrit përgjegjës për ekonominë do të krijojë dhe mirëmbajë një bazë të dhënash, e cila aksesohet *online* nga pjesëmarrësit e tregut dhe autoritetet publike. Baza e të dhënave të produkteve nuk do të zëvendësojë ose modifikojë përgjegjësitë e autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut.

7. Baza e të dhënave të produkteve do të shërbejë për qëllimet e mëposhtme:

a) të mbështesë autoritetet e mbikëqyrjes së tregut në kryerjen e detyrave të tyre sipas kësaj rregulloreje dhe akteve përkatëse të deleguara, duke përfshirë zbatimin e saj;

b) t’i ofrojë publikut informacion në lidhje me produktet e vendosura në treg dhe etiketat e tyre të energjisë, si dhe fletët e informacionit të produkteve;

c) t’i ofrojë Komisionit informacion të azhurnuar për efikasitetin e energjisë për produktet për shqyrtimin e etiketave të energjisë.”.

Neni 5

1. Titulli i kreut II të ligjit ndryshohet si më poshtë: “Kërkesat për informacion dhe projektim ekologjik”.

2. Pas nenit 7 shtohen nenet 7/1 dhe 7/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 7/1

Kërkesat e projektimit ekologjik

1. Produktet me ndikim në energji të vendosura në treg duhet të përmbushin kërkesat e projektimit ekologjik të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë dhe për ekonominë miraton rregullat e detajuara për projektimin ekologjik të produkteve me ndikim energjetik, si dhe kërkesat për etiketimin e këtyre produkteve.

3. Kërkesat mund të përfshijnë kërkesa për: kufizimin e konsumit të energjisë, përdorimin e burimeve, zvogëlimin e materialeve të rrezikshme, riparueshmërinë dhe riciklueshmërinë.

4. Procedurat e verifikimit të konformitetit rregullohen sipas parashikimeve të këtij ligji, akteve nënligjore në zbatim të tij dhe ligjit që rregullon sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore.

5. Prodhuesi, furnizuesit, importuesi apo tregtari duhet të përgatisin dosjen teknike të produktit sipas përcaktimeve që bëhen në vendimin e Këshillit të Ministrave, sipas pikës 2 të këtij neni, e cila do të përmbajë të paktën analizën e ciklit të jetës dhe dokumentacion provues.

Neni 7/2
Strukturat përgjegjëse

1. Struktura përgjegjëse për doganën verifikon përputhshmërinë e kërkesave të këtij ligji për projektimin ekologjik të produkteve në momentin e importit të tyre në vend.
2. Strukturat përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut të produkteve joushqimore verifikojnë përputhshmërinë për produktet e vendosura në qarkullim.
3. Strukturat përgjegjëse monitoruese bashkëpunojnë mes tyre për zbatimin e parashikimeve të këtij ligji për projektimin ekologjik përgjatë gjithë ciklit të jetës së produktit.”.

Neni 6

Në nenin 14, pika 1, pas shkronjës “ë” shtohet shkronja “f” me këtë përmbajtje:

“f) për shkelje të parashikimeve të këtij ligji për projektimin ekologjik dhe akteve nënligjore në zbatim të tij me gjobë në masën 350 000 lekë”.

Neni 7

Në nenin 17 të ligjit, “Aktet nënligjore”, pas paragrafit të parë shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

“Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 12 muajve të miratojë aktin nënligjor në zbatim të nenit 7/1, pika 2, të këtij ligji.

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që bazën e të dhënave sipas parashikimeve të nenit 6, pikave 6 dhe 7, të ligjit me anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian ta përputhë plotësisht me kërkesat e akteve ligjore të Bashkimit Evropian në fuqi.”.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.4.2026.

Shpallur me dekretin nr. 314, datë 14.5.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.